



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS SOLEMNE TË KUVENDIT TË KOSOVËS ME RASTIN E
SHËNIMIT TË 32-VJETORIT TË RËNIES SË ATDHETARËVE TAHIR
DHE NEBIH MEHA NË BETEJËN E PREKAZIT TË EPËRM,
E MBAJTUR MË 13 MAJ 2013**

**SA SVEĆANE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
POVODOM OBELEŽAVANJA 32. GODIŠNJICE PALIH RODOLJUBA
TAHIR I NEBIH MEHA NA BITKU GORNJEG PREKAZA,
ODRŽANE 13. MAJA 2013. GODINE**

**MAJ - MAJ
2013**

Mbledhjen solemne e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar qytetarë të pranishëm,
E nderuara Familje Meha
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Mirë se keni ardhur në seancën plenare me rastin e shënimit të 32-vjetorit të rënies së atdhetarëve Tahir dhe Nebih Meha në betejën e Prekazit të Epërm.

E ftoj deputetin Ramiz Lladrovci, që në emër të kërkesës dhe përfaqësimit të grupit propozues, ta marrë fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: I nderuar kryetar,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
E nderuara Familje Meha,
Të nderuar familjarë të dëshmorëve,
Në ngjarjet e vullshme të vitit 1981, Serbia e shfrytëzoi pikërisht të ashtuquajturën Ditën e Policisë së Jugosllavisë për ta sulmuar Familjen Meha, heroin Tahir Meha, babanë e tij Nebihun dhe të gjithë bashkëfamiljarët e tyre.

Prekazi i Ulët i Drenicës u bë atë ditë fushëbetejë dhe vulë e një varg ngjarjesh të pranverës '81. Pas arrestimeve të shumta të rinisë kosovare, anembanë vendit, gjatë demonstratave kosovare të atij viti, Jugosllavia e atëhershme kishte për synim të dëshmojë forcën mbi shqiptarët e Kosovës. Dhe, adresa e tyre ishin Mehajt e Prekazit të Ulët. Por, një ushtri, një polici dhe një makineri e tërë u thye atë ditë në Kullën e Mehajve, në çerdhen njëshekullore të rezistencës ndaj të gjithë kajlave.

Rrethimi prej tre rathësh i Kullës së Mehajve nga njësia speciale, ushtria jugosllave dhe pjesëtarë të policisë rezervë, nuk i thyen assesi Tahirin, Nebihun dhe familjen Meha. Ata qëndruan deri në fundin e natës, duke lënë të vrarë 24 pjesëtarë të njësive speciale jugosllave dhe shumë të plagosur, përkundër faktit që zyrtarisht ishin deklaruar vetëm 4 policë të vrarë dhe 3 të plagosur.

Pushteti i atëhershëm nuk i kishte deklaruar të vrarët tjerë, që ishin jetimë të rritur pa prindër dhe të rekrutuar për këto ekspedita. Kulla e Mehajve të Prekazit ishte po ajo kulla e gjyshit të Tahir Mehës, Emin Latit, që kishte qenë pjesë e çerdhes së Azem Bejtës dhe që asnjëherë s'iu dorëzua pushteteve antishqiptare.

Kjo familje jorastësisht u sulmua më 13 majin e vitit 1981. Tahir Meha, babai i tij Nebihu dhe të gjithë anëtarët e kësaj familjeje, ishin njëqind vjet më parë të betuar për të mos iu nënshtruar asnjë regjimi antishqiptar. Në vend të nënshtrimit, ata e zgjodhën rezistencën.

Edhe pse pushteti i shpalli rebelë dhe pengmarrës, sipas referimeve në raportet e kohës së agjencisë zyrtare Tanjug, të gazetës “Rilindja” dhe “Jedinstvo”, megjithatë Tahir e Nebih Meha ishin patriotë të vërtetë shqiptarë. Ishin arteria e gjallë dhe aktive e kësaj kohe.

Jorastësisht edhe heronjtë e mëvonshëm, si Adem e Hamzë Jashari nga Prekazi i Poshtëm, u betuan pikërisht mbi varret e tyre, se jeta e tyre do të ecën rrugës dhe amanetit të Mehajve. Ata këtë betim e kishin bërë pikërisht në ditën e varrimit të Tahir e Nebih Mehajt.

10 vjet më vonë, po kundër të njëjtit regjim pushtues, dhe më 30 dhjetor të vitit 1991 dhe në janarin e vitit 1998 me të njëjtun skenar do të rezistojë në Prekazin e Poshtëm komandanti legjendar Adem Jashari, Hamza dhe mbarë familja Jashari.

Ndërsa, në marsin e vitit 1998, ata do të bien heroikisht, duke mos iu dorëzuar për asnjë moment po të njëjtit regjim, po të njëjtave forca policore e ushtarake të Beogradit dhe duke tërhequr vëmendjen e tërë opinionit të gjerë ndërkombëtar për të vërtetën se ç’po ndodhë në Kosovë dhe me shqiptarët.

Të nderuar deputetë,

Sot është një mundësi e mirë për të gjithë ne, që pikërisht sakrifica njëshekullore e shqiptarëve të Kosovës na e ka ofruar për ta kujtuar e nderuar këtë sakrificë institucionalisht dhe me rrugë shtetërore, sikur po bëjmë në këtë seancë solemne.

Është detyrë dhe privilegj i secilit prej nesh që t’i nderojmë dëshmorët e kombit, heronjtë e mëdhenj, ata që duke e tejkaluar veten u bënë themel i lirisë, i shtetit dhe institucioneve që bashkë po i ndërtojmë. Beteja e 13 majit 1981, rënia e Tahir e Nebih Mehajt, babë e bir në atë betejë ishte rënie për lirinë tonë, për shtetin që sot e gëzojmë dhe e ndërtojmë bashkërisht, ishte frymëzim për gjeneratat e mëpastajme deri te lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës se si duhet të jetohej dhe se si duhet të vdiset për atdheun.

Ne sot nuk po e nderojmë veç një njeri, veç një ngjarje apo një moment. Mehajt dhe 13 maji i vitit 1981, i Pranverës së Madhe Shqiptare të Kosovës, ishte veç një nyje në një histori njëqindvjeçare. Forcat serbo-jugosllave atë ditë, jo për herë të parë dhe të vetme, u kthyen kokulur nga Prekazi, të cilin po ashtu jo për herë të parë e të vetme e kishin mësyre ta nënshtrojnë e ta thyejnë, ta godasin krenarinë e shqiptarëve, dellin e kryengritjes sonë të përhershme.

Beogradi ishte kthyer i thyer e dërrmuar nga Prekazi dhe me njësitë e xhandarëve të kohës së Ahmet Delisë. U kthye po ashtu kokulur më 13 majin e vitit ‘81 nga rezistenca deri në frymën e fundit të Tahir Mehajt. Serbia u kthye kokulur dhe e poshtëruar nga Prekazi edhe në vitin ‘91, kur Adem Jashari ia dha përgjigjen e duhur. Ashtu u kthye edhe në vitin ‘98, kur pikërisht nga komandanti legjendar Adem Jashari dhe familja Jashari e Prekazit të Drenicës e mori përgjigjen dhe goditjen përfundimtare nga këtu.

Atë ditë maji të ‘81-ës ranë Tahir e Nebih Mehaj, e u plagos e bija e Tahirit, Mihrija. Atë ditë Prekazi i dha vulën vitit 1981. Atë ditë dy ranë, me mijëra u ngritën. Ndërsa,

familjarë e pasardhës të familjes Meha do të jenë pjesëtarë aktivë dhe të paepur të UÇK-së, si vëllai i Tahir Mehajt, Beqiri që ishte bashkëluftëtar i komandantit legjendar Adem Jashari dhe Emin Ladi i Ri, që e kemi në mesin tonë stërnipi i Emin Ladit të Parë, që ishte bashkëluftëtar dhe pjesëtar i Çetës së Azem Bejtës.

Kjo është një shekull historie e shkruar me gjak, një shekull historie e qëndresës, refuzimit dhe luftimit të regjimit anti-shqiptar të Beogradit. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetari i Kuvendit, zoti Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,
E nderuar Familje Meha,
Të nderuar familjarë të dëshmorëve,
Zonja dhe zotërinj,
Qytetarë të nderuar,
Në fund të viteve të '80-ta të shekullit të kaluar, Lëvizja jonë Kombëtare kishte një përvojë të shkëlqyer të veprimtarisë së gjatë e të pazbuluar nga rrjeti policor i UDB-së. Ajo kishte sqaruar popullin e Kosovës për gjendjen e tij prej robi dhe po e mobilizonte për rezistencën masive.

Gjendja, si në gjithë Kosovën, më 1981 ishte e rëndë edhe në Universitet, ku studentët u ngritën fillimisht për të kërkuar kushte më të mira të studimit. Por, demonstratat e 11 dhe 26 marsit u bënë shkëndija për ta ndezur zjarrin e revoltës së popullit kryengritës.

Në fillim të prillit 1981, nën parullën "Kosova-Republikë", tërë Kosova u ngrit në këmbë me kërkesën për t'u bërë e barabartë me njësitë tjera të federatës jugosllave. Kthesën historike e vuri në lëvizje energjia e pashtershme patriotike e Kosovës. Rrugët u mbushën përplot heronj të gjallë, pleq e të rinj, burra, gra e fëmijë, të cilët shkonin drejt vdekjes si në dasmë.

Mahatma Gandhi ka thënë: "Në çastin që skllavi vendos të mos jetë më skllav, prangat e tij janë këputur".

Në pranverën e vitit 1981, në Kosovë ndodhi demonstrimi plebishitar i vullnetit politik të shqiptarëve, në njërën anë dhe hyrja në luftë e forcave serbe e jugosllave me popullin duarthatë, por liridashës, në anën tjetër.

Demonstratat paqësore u kthyen në ngjarje të përgjakshme nga makina shtypëse jugosllave, që po i shërbente politikës hegjemoniste e ekspansioniste të Beogradit. Kryengritja u vulos me gjakun e militantëve të Lëvizjes së organizuar, Naser Hajrizi e Asllan Pireva dhe të demonstruesve të tjerë, si Xhelal Maliqi e Salih Abazi, Ruzhdi Hyseni e Salih Mulaku, Rizah Matoshi e Sherif Frangu, të të rinjve Nesimi Dervishdana,

që u vra në Gjakovë, e të Ibrahim Krasniqi e Afrim Abazi, të mbytur në burgjet jugosllave.

Ende pa u tharë gjaku i dëshmorëve të demonstratave të vitit 1981, më 13 maj 1981, forcat speciale të policisë jugosllave, të shoqëruara edhe me trupa ushtarake të blinduara dhe me helikopterë gjuajtës, ia mësynë Prekazit legjendar të Drenicës, për ta zhbërë familjen kryengritëse të Tahir Mehës.

Ditën e festës së saj, policia dëshironte ta shënonte pikërisht në Prekaz, duke vrarë atdhetarë e provokuar Drenicën dhe mbarë Kosovën.

Tahir Meha, bashkë me babanë e tij dhe familjen, të fortifikuar në kullën e tyre, vendosën të qëndronin, sipas amanetit të Emin Latit e Ahmet Delisë, të Kamer Loshit e Azem Galicës, duke rezistuar me armë në dorë.

Luftimet vazhduan gjatë gjithë asaj dite të majit të vitit 1981, midis një familjeje në vatrën e saj dhe një soldateske të tërë gjakpirëse, me armatimin më modern. Në mbrëmje, forcat u tërhoqën me 8 të vrarë, duke lënë pas Nebih e Tahir Mehën, babë e bir dëshmorë dhe kullën e tyre rrafshuar me tokë.

Pushkët e Mehajve të Prekazit më 13 maj 1981 jehuan si kushttrim Drenice për rezistencë kundër pushtuesit, duke shënuar faqe lavdie të historisë sonë. Shembulli i Tahir e Nebih Mehës i edukoi brezat vijues të Kosovës për t'ia kthyer pushkën armikut, pavarësisht fuqisë së tij. Krismat e Prekazit e dërguan në mbarë botën mesazhin e një populli të robëruar, që herët a vonë do të ngrihej me armë në dorë për lirinë e tij.

Kryengritja e vitit 1981 dhe qëndresa e Prekazit u bënë forcë shtytëse e zhvillimeve në procesin e çlirimit të Kosovës nga sundimi serbomadhi dhe pararendëse të luftës për liri, të kulmuara në epokën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Komandantit të saj Legjendar, Adem Jashari.

Në këtë përvjetor, të 32-tin e rënies së tyre, përkulemi para kujtimit të dëshmorëve Tahir e Nebih Meha, para të gjithë dëshmorëve të kombit të asaj plejade.
I përjetshëm qoftë kujtimi për ta!

Faleminderit për vëmendje!

Drejtimitin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Mysafirë të pranishëm,
Ju falënderoj për pjesëmarrje në këtë seancë përkujtimi të një ngjarjeje të rëndësishme të historisë sonë. Këtu seanca i mbyll punimet. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*